



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 43 DATË 09.07.2021

MBI MIRATIMIN E VLERËS SË INVESTIMIT PËR OBJEKTIN RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS “UNAZA E RE” NË LAGJEN “28 NËNTORI”, MIRATIMI I VLERËS SË SUPERVIZIMIT DHE KOLAUDIMIT TË OBJEKTIT.

Këshilli i Bashkisë Dimal në mbledhjen e tij të datës 09.07.2021, bazuar në materialin informacionin e paraqitur dhe relatuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Financës në Bashkinë Dimal, në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “.Neni 8 pika 2, Neni 9 pika 1.1b, Neni 34 ,35,36,37,40,41,54 pika dh ,Neni 55, Neni 64 pika c, Ligji Nr 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore “.Neni 45, Ligjit Nr 107/2014”Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit “, të ndryshuar ,VKM 408 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit”, e ndryshuar, VKM 354/2016 “Për miratimin e Manualit të Tarifave në Shërbim, Planifikim, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”, Aktit Normativ Nr 26 Datë 23.06.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr 137/2000”Për Buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, VKB Nr 81 datë 24.12.2020”Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Dimal për vitin 2021”, të ndryshuar si dhe shkresën e Ministrisë së Financave Nr 116161/2, Datë 30.06.2021, Ligj Nr 34/2021 datë 16.03.2021 ”Për Ndryshimin e Emërimit të Njësisë së Qeverisjes Vendore nga “Bashkia Ura Vajgurore” në “Bashkia “Dimal”, Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Numri 55 e Enjte ,8 Prill 2021.

VENDOSI:

Me 17 vota PRO nga 17 Këshilltarë prezentë të miratojë :

1. Të miratojë vlerën e investimit në rrjetin rrugor rural për objektin “Rikonstruksioni i Rrugës Unaza e Re “ ,në lagjen “28 Nëntori” Ura Vajgurore në masën 100,224,601 lekë me tvsh.
2. Të miratojë vlerën e mbikqyrjes për 948685 lekë me tvsh.
3. Të miratojë vlerën e kolaudimit prej 113842 lekë me tvsh.
4. Ky projekt do të financohet nga transferta sektoriale, të Buxhetit të Shtetit, për investime në rrjetin rrugor nga të ardhurat e Bashkisë.
5. Financimi për vitin 2021, do të jetë 20.000.000 lekë me tvsh.
6. Bashkëlidhur këtij vendimi “Preventivi Përmbledhës i Projektit”.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Dimal.
8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “, të ndryshuar.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Hysen Hoxha



